



## ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

---

### Deklaratë e Kuvendit të Odës së Mjekëve të Kosovës

Tanimë kur jemi duke hyrë në periudhën e konkretizimit të hapave konkret për jetësimin e nismave serioze për reformimin e sistemit shëndetësor përmes koordinimit të aktiviteteve në mes akterëve të sistemit.

Në gjithë këtë “mozaik” aktivitetesh, Ligji i Pagave ka zënë si asnëherë më parë koordinim sektorial të pazakonët, por lëvizjet e fundit të komisionit qeveritar dhe MAP bënë brengosë qëndrueshmërinë e reformave dhe të vet sistemit shëndetësorë dhe rrezikshmërisht qëndrueshmërinë e paqes sociale.

Në këtë drejtim, OMK në bashkërendim me MSH kemi analizuar projekt-ligjin për paga dhe ka dhënë komentet dhe propozimet reale dhe krasimore me të gjitha profesionet tjera në Kosovë.

Për habinë tonë, drafti i cili ka dalur në diskutim publik është ndryshuar në mënyrën më brutale dhe pa asnjë arsyeshmëri analitike dhe logjike.

Komisioni qeveritar dhe MAP, si duket, vazhdon “sagën” e denigrimit të vazhdueshëm që i është bërë mjekut në statusin e tij ekonomiko-social, tanimë po tentohet për ta marr edhe formën ligjore.

Nga statusi formal kur dikur mjekët në mënyrë me absurde konsideroheshin si shërbyes civil, deri tek trajtimi në mënyrë më të padinjitetshme në nivele më të ulta përgjatë viteve në kuptim të nivelit të pagës, ka bërë që mjeku të trajtohet edhe në sferën shoqërore në mënyrë jo meritore, dhe duke u bazuar në trendet pozitive të ndërmarra nga Ministri i Shëndetësisë dhe Kryeministri në këtë aspekt mund të konkludohet se kjo tendencë do të bëjë të parealizueshëm këtë trend.

Pra, derisa në diskursin publik, shëndetësia po trajtohet si shtyllë kryesore e shoqërisë, mjeku si bosht i kësaj shtylle shoqërore, sot në shoqërinë tonë ka tendencia për të lënë mjekun në pozitën më të ulët, si në kuptim të integritetit të tij ashtu dhe respektit dhe sigurisë personale. Sepse, pozita e tillë shoqëroro-ekonomike është e papranueshme dhe nuk mund të jetë e tolerueshme, mjeku meriton trajtim të dinjitetshëm si në kuptim të statusit të tij profesional përmes formalizimit në Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitet e Mjekut, ashtu dhe pozitën ekonomiko-sociale e cila duhet të rregullohet me Ligjin për Pagat e Funksionarëve Publik.

Prandaj, Kuvendi i OMK-së i bënë thirrje të gjitha institucioneve kompetente, që në procesin final të formësimit të draftit final të projektligjit të pagave të bëhet barazvlerësimi i pagave të mjekëve në nivelin e pagave ashtu siq është propozuar nga ana e OMK-së në koordinim me MSH dhe në përputhje me organizatën sindikale, përndryshe as që mund të mendohet realizimi i reformave të filluara në shëndetësi e as të paramendohet ndalja e ikjes së mjekëve për një jetë më dinjitoze.

Andaj, të nderuar vendimmarrës në fund ju bëjmë thirrje që të merren për bazë kërkesat tona minimaliste që të bëhet barazvlerësimi i pagave të mjekëve në nivelin e pagave të gjyqtarëve në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës (draft propozimi aktual për mjekët, me shkollim obligativ prej 11-13 vjeçar, Komisioni Qeveritar i ka renditur me kofiqjenit nga 3,0 deri në 4.0 ndërsa për gjyqësorin nga 5.0 deri në 7.5), në të kundërtën përgjegjësinë për kolapsin në sistemin shëndetësor nuk do ta bartin punëtorët shëndetësor por nivelet vendimmarrëse politike në vend.

Me respekt,

Kuvendi i Odës së Mjekëve të Kosovës



19.06.2018, Prishtinë